

WE ARE YOUR DOL



Department
of Labor

NJIHNI TË DREJTAT TUAJA SI TË PUNËSUAR

Si të Parandalohen Shkeljet në Vendin e Punës

Nëse i njihni të drejtat tuaja, sipas Kodit të Punës të Shtetit të Nju Jorkut, mund të mbronni veten në vendin e punës. Më poshtë gjeni disa fakte dhe këshilla bazë për t'u pasur parasysh në punë.

PAGAT

Gjithkush ka të drejtë të marrë të paktën pagën minimale, pavarësisht llojit të punës apo punëtorit. Nëse punoni më shumë se 40 orë në javë, duhet të merrni pagesë shtesë për kohën shtesë që po punoni, megjithëse ka përjashtime për punonjësit e kujdesit në shtëpi.

Duke filluar nga 1 janari 2024, punëtorët e fermës, të cilët punojnë më shumë se 56 orë në javë, duhet të marrin pagë shtesë në masën 1 1/2 herë më shumë se norma e tyre e rregullt e pagës për orët shtesë të punës.

Për detaje mbi normat e pagës minimale në shtetin e Nju Jorkut, ju lutemi vizitoni dol.ny.gov/minimum-wage.

Ligjet për pagën minimale dhe jashtë orarit vlejnë për TË GJITHË PUNËTORËT, edhe nëse jeni pa dokumente ose të paguar:

- Për punë me orë, ditore ose javore
- Me para në dorë ose me çek
- Punë në të zezë

Pyesni për paraqitjen e një ankese nëse mendoni se nuk merrni pagën minimale ose nuk merrni më shumë para për kohën shtesë që punoni. Na telefononi në **888-469-7365**.

KOMPENSIMI I PUNONJËSVE

Pavarësisht nga statusi juaj i imigracionit, mund të merrni kompensimin e punëtorëve nëse lëndoheni në punë. Kontaktoni Advocate for Injured Workers (Avokatin për Punëtorët e Lënduar) për ndihmë në **800-580-6665**.

MBRONI VETEN

Shkruani sa më shumë informacion që mundeni, në rast se keni nevojë të bëni një ankimim. Kjo përfshin:

- Emri i PLOTË i punëdhënësit (emri, mbiemri dhe numra kontakti)
- Adresa dhe/ose numri i telefonit të vendit ku keni punuar
- Numri i shtetit dhe targa e makinës (nëse dikush ju merr për një punë)

- Informacioni i kontaktit (emrat dhe numrat e telefonit)
- Kohët kur filloni dhe ndaloni punën (përfshini sa kohë keni pasur në dispozicion për ushqim)
- Sa ka rënë dakord punëdhënësi t'ju paguajë Shkruani emrin e kompanisë të shënuar në çdo leje ose licencë, ose kërkoni një kartvizitë. Në këtë mënyrë punëdhënësi e di që ju keni informacionet e tij të kontaktit dhe do të ketë më pak gjasa të shkelë ndonjë pikë të kodit të punës.

Nëse keni një telefon me kamerë, mund të bëni fotografi të vendit të punës dhe të kolegëve tuaj, duke përfshirë mbikëqyrësin. Kjo mund t'ju ndihmojë me një ankimim.

SHENJAT PARALAJMËRUESE

Ka shumë shenja që mund t'ju paralajmërojnë për shkeljet e kodit të punës. Ju mund të jeni viktimë e vjedhjes së pagave, nëse:

- Nuk merrni një regjistrim të orëve të punës (nëse paguheni me çek ose me para në dorë)
 - Tarifoheni për pajisjet e nevojshme për të punuar ose për dëmtimin e pronës
 - Punoni të paktën gjashtë orë rresht dhe nuk keni të paktën një vakt ushqimi prej gjysmë ore
- Nëse keni një problem lidhur me punën me një punëdhënë, Departamenti i Punës mund t'ju ndihmojë të bëni një kërkesë.

PËR NDIHMË

Nëse dëshironi të bëni një ankesë, telefononi Departamentin e Punës të shtetit ku keni punuar.

Më poshtë janë numrat e telefonit për disa Departamente të Punës.

Nju Jork:	888-469-7365
Nju Xhersi:	609-292-2305
Konektikat:	860-263-6790
Pensilvania:	717-787-4671
Masacuset:	617-626-6975

New York State Department of Labor
Divizioni i Politikave dhe Çështjeve të Imigrantëve
877-466-9757